



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 718 / Prot
1

Tiranë, më 1 / 7 / 2016

Lënda: Jepet mendim lidhur me mundësinë e transferimit të të dhënave personale të shtetasve shqiptarë që kanë kryer shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor jashtë territorit të Shqipërisë, në adresë të kompanisë EuroParking Collection (me qendër në Britaninë e Madhe)

Drejtuar: Z. Eduart SEITAJ

Sekretar i Përgjithshëm

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 2790/3 Prot, datë 24.06.2016, nëpërmjet të cilës kërkohet mendim për kërkesën e paraqitur pranë institucionit tuaj nga kompania EuroParking Collection me qendër në Britaninë e Madhe "Për shkëmbimin e informacioneve për zotëruesit e mjeteve rrugore që kanë kryer shkelje trafiku jashtë territorit të Shqipërisë", në vijim do të gjeni analizën tonë në referim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor (DPSHTRR) në cilësinë e kontrolluesit në kuptim të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, administron "arkivin elektronik kombëtar të automjeteve të transportit", në të cilin mblidhen dhe përpunohen të dhëna mbi gjeneralitetet, pasurinë e një individit, personi fizik, juridik, etj. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të mësipërme duhet të kryhet duke respektuar kërkesat e ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Kërkesa e drejtuar nga kompania EuroParking Collection ka të bëjë me zbatimin e nenit 8 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Sipas këtij neni thuhet shprehimisht se *"1. Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale kryhet, me marrës, nga shtete me një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Niveli i mbrojtjes së të dhënave personale për një shtet përcaktohet duke vlerësuar të gjitha rrethanat lidhur me përpunimin, natyrën, qëllimin dhe kohëzgjatjen e tij, shtetin e origjinës dhe destinacionin përfundimtar, aktet ligjore dhe standardet e sigurisë në fuqi në shtetin marrës. Shtetet, që kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, përcaktohen me vendim të Komisionerit"*.

Në parim, ky transferim mund të kryhet pasi Britania e Madhe është shtet me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave sipas Vendimit nr. 3, datë 20.11.2012 *"Për përcaktimin e shteteve, me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale"*, ndryshuar me Vendimin nr.7, datë 09.02.2016, miratuar nga Komisioneri.

Por, në rastin konkret transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale do të duhet të kryhet vetëm nëse DPSHTRR në rolin e kontrolluesit të të dhënave vepron në kushtet e respektimit të neneve 5 dhe 6 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar.

Neni 5/1/b i ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar, përcakton se *"... të dhënat personale duhet të grumbullohen për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime"*. Në interpretim të kësaj dispozite, nga DPSHTRR kërkohet që përpunimi i të dhënave personale të administruara në *"arkivin elektronik kombëtar të automjeteve të transportit"*, të kryhet në përputhje me qëllimin për të cilin ato janë mbledhur.

Shkëmbimi i të dhënave me një kontrollues tjetër siç është kompania EuroParking Collection, kërkon së pari verifikimin, nëse ajo është e legjitimuar për të bërë kërkesën, nëse kompania ka përcaktuar qëllimin e përpunimit si dhe të dhënat që kërkohen janë të mjaftueshme për përmbushjen e qëllimit.

Kërkesa e drejtuar nga kompania EuroParking Collection duhet të analizohet në vështrim të nenit 6/1/a/ç/d të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar, në të cilin shprehimisht thuhet *"1. Të dhënat personale përpunohen vetëm: a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin; ç) për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit; d) për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat."*

Në përfundim, nga ana juaj duhet të vlerësohet nëse kërkesa e paraqitur është e bazuar në legjislacionin rrugor dhe nëse ajo është në përputhje me parimin e reciprocitetit dhe praktikat që ndiqen në lidhje me mbledhjen e pagesave nga shkelësit e trafikut.

Në rastin e një transferimi të mundshëm të të dhënave, lind detyrimi për të njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI

